



Npi – 01/278 datë: 24.11.2020

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.11 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/149 të datës: 31.05.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 24.11.2020 është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -IX- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES
E mbajtur më: 24.11.2020, e (martë) në ora 10.⁰⁰ h. ON-LINE në zyrën e Kryetarit.

Mbledhja e Kuvendit është organizuar për tu mbajtur ON-Line (nga distanca) për shkak të pandemisë KOVID19, Kryesuesja e Kuvendit znj.Medina Brahaj me nënshkrimin e sajë konfirmon se në mbledhje kanë marrë pjesë të gjithë anëtarët e Kuvendit, si vijon: znj.Medina Brahaj, z.Perparim Ramusa, z.Shefki Dauti, z.Herolind Selmani, z.Reshat Mujota, znj.Arbresha Sylja, z.Milot Deliu, znj.Fatmire Ferati, z.Naim Zejna, z.Skender Hyseni, znj.Zarife Rexhaj, znj.Valentina Halili-Ferati, z.Ruzhdi Jashari, z.Besnik Seferi, znj.Marigona Pajaziti, z.Fehmi Hysenaj, znj.Adelina Beqaj, z.Isak Muslija, znj.Diarta Vishesella, z.Muhamet Ademaj, dhe z.Rexhep Gashi.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstatoj, Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar mbledhjen e Kuvendit nga distanca. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 29.10.2020,
2. Pyetje-Pergjigje,
3. Shqyrtimi i Raportit Financiar, Janar-Shtator 2020,
4. Draft-Rregullore Komunale për Tatimin në Pronë për vitin 2021, pas diskutimit publik,
5. Rishqyrtimi i katër Vendimeve të Kuvendit Npi-01/209; Npi-01/210; Npi-01/211; Npi-01/217, sipas kërkesës së MAPL-së,
6. Propozim-Vendim për shpalljen me Interes Publik të Ngastrave Kadastrale, Nr.313/3, 313/4, 313/5 dhe 313/6, Z.K – Davidovc, evidentuar pronë e Sali Beqaj – Petrovë,
7. Propozim-Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën Komunale, Nr.230/0 dhe Nr.251/0, Z.K-Dugë,
8. Propozim-Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtë pronën Komunale, Nr.2270/4, Z.K-Shtime,
9. Propozim-Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën Komunale, Nr.333/3 dhe 333/4, Z.K-Davidovc,
10. Formimi i Komisionit për ndryshimin e Rregullores të Punës së Kuvendit dhe hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2021.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Ruzhdi Jashari; Përshëndetje për të gjithë. Në KPF kam kërkuar që për 4 pikat e rendit të ditës 5, 6, 7 dhe 8 që kanë të bëjnë me dhënien e pronës komunale në shfrytëzim, vota ime me u evidentuar në procesverbal si votë “Kundër” prandaj edhe këtu në Kuvend, unë po propozoj që të hiqen nga rendi i ditës pikat e propozuara 6, 7, 8 dhe 9. Pse kjo nguti, për këto prona duhet të respektohet Ligji dhe procedurat ligjore, nuk naj ka shti askush thojt ne fyt, ne kemi ble rreth 4 hektarë tokë në Vojnovc me mbi 300 mijë euro, prandaj ne përfaqësuesit e subjektit politik të Vetvendosjes deklarohemi se këto pika duhet të hiqen nga rendi i ditës.

z.Fehmi Hysenaj; Përshëndetje për të gjithë, ftesat i kemi marrë me kohë. Lidhur me propozimet që i bëri parafolësi unë po kërkoj nga Zyrtari Ligjorë që të na tregojë se a janë përfilluar procedurat Ligjore, sepse edhe unë kam bërë ankesë për shkak të procedurës dhe vendimet janë kthyer për rishikim.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; A ka Zyrtari Ligjor me shtuar diqka, nëse jo atëherë po vazhdojmë. Në vazhdim Konstatoi Kuorumin, prej 15 anëtarëve prezent në mbledhje On-Line.

*** Kuvendi i Komunës, me 12 vota “Për” me 2 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” aprovoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 29.10.2020

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Fehmi Hysenaj; Nuk kam ndonjë vërejtje, por e komplimentoj Zyrtarin e Kuvendit për korrektësi.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 15 anëtarëve prezent On-line.

*** Kuvendi i Komunës, unanimisht aprovoi, Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 29.10.2020, pa vërejtje.**

Pika 2

Pyetje-Përgjigje

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Fehmi Hysenaj; Unë pyetjet e mia i dërgoj me E-mail, dhe nuk keni nevoj me i shkruar në procesverbal, por sido që të jetë unë po i lexoj këtu për kolegët dhe publikun, unë kam këto pyetje:

1. Këto ditë kemi marrë shumë ankesa nga bujqit që kanë aplikuar për subvencione nga Ministria e Bujqësisë. Sipas informatave që kemi marrë rreth 70 bujq nuk kanë arritur të përfitojnë nga kjo e drejtë dhe lëndët u janë kthyer si të pakompletuara. Në këtë rast mbi kë bie përgjegjësia: mbi bujqit që nuk është e thënë të jenë të shkolluar dhe patjetër të dinë se ç’dokumente duhet të dorëzojnë, apo mbi zyrtarët që i pranojnë këto dokumente?

2. Pse në Gjimnazin “Naim Frashëri”-Shtime, nga fillimi i vitit ne disa klasë të dhjeta nuk mbahet asnjë orë e fizikës, dhe a rrezikohet që nxënësit të humbasin vitin?

z.Besnik Seferi: Unë kam këto pyetje:

1. Pse nuk po bëhet mirëmbajtja e shkollës profesionale si duhet, pse kontraktori për mirëmbajtjen e higjienës në shkollë nuk po e kryen punën e vet si duhet?

2. Deri kurë unë do të parashtrij të njejtën pyetje, për sa i përket pastrimit të rrugës “Çamëria” përse DSHP-ë nuk ka inspektuar këtë rrugë dhe pse nuk po ndërmerr asgjë për sa i përket largimit të mbeturinave në trotualet e kësaj lagje?

z.Muhamet Ademaj: Kam këto pyetje:

1. Pyetje për DPUKGJ-në, a kanë leje ndërtimore disa objekte që kanë filluar të ndërtohen në rrugën “Tranzit” fjala është prej rrethit të rrugës së Ferizait në drejtim të fshatit Davidovc?

z.Naim Zejna: Unë kam këto pyetje:

1. Pse nuk po bëhet rrethoja e fushës së sportit në fshatin Vojnovc, kur dihet se ka nevojë shumë për shkak të lumit që gjendet afër?

2. Pyetja e dytë është për DSHP-në që ka të bëjë me gjendjen e rrymës në rrugën “Mic Sokoli”, “Komandant Kumanova dhe “Zenun Beqa” a ka ndërrmarrë diçka drejtoria dhe a është që kemi një kundërshtim të madh të banorëve për shkak të gjendjes së keqe me rrymë në këto lagje, edhe pse po e dimë se si është gjendja karshi KEDS-it?

3. Pyetja e tretë gjithashtu ka të bëjë me rrymën por tani te Puset e Ujsjellësit, rryma te pusët ka qenë me një rrjet të veçant, me sa duket janë kyqur shumë banorë aty dhe kur ndalet rryma pas një kohe të shkurtë ndalet edhe uji, çka po ndërrmerr administrata përkatësisht resori gjegjësisht për eliminimin e këtijë problemi?

z.Ruzhdi Jashari: Unë kam këto pyetje:

1. Pyetja ime është specifike, si është gjendja me Pandeminë KOVID19, sepse nuk e kemi asnjë informacion në këtë seancë?

2. Pyetja e dytë për DKA-në qysh është gjendja në arsimin e Komunës tonë, a është kah zhvillohet mësimi apo nuk është kah zhvillohet fare, kur e dimë se ka mësimdhënës të prekur, kur dimë se mirëmbajtja në shkollat tona nuk po bëhet si duhet?

z.Skender Hyseni: Unë kam tri pyetje:

1. Pyetja e parë është për Kryetarin, dhe Shtabin Emërgjent, si jemi momentalisht me rezerva për sa i përket mbrojtjes nga pandemia KOVID19.

2. Pyetja e dytë, nëse kemi mjete financiare në buxhet të pa shfrytëzuara, i kisha lutë që të marrim një hap sikurse Komuna e Prishtinës dhe ti ndihmojmë ose fermerëve ose qytetarëve atyre që e kanë gjendjen më të vështirë?

3. Pyetja e tretë, a ka diçka, lidhur me pastrimin e shtratit të Lumit Shtimjanja, sepse vërtetë është ngushtuar shumë?

z.Shefki Dauti: Unë kam këto pyetje:

1. Pyetje për drejtorinë përkatëse, meqenëse jemi në prag të festës së flamurit 28 Nëntor, unë propozoj që në të gjitha vendet të Përmendoret të Lapidarët etj. të ndërrohen flamujt pasi kemi kohë ende?

z.Rexhep Gashi: Unë kam këto pyetje:

1. Pyetje për DSHP-në, çka ka ndodhur me fatin e një skulpture të cilën e kemi paguar 9800€ që ka qenë e vendosur në Sheshin e Dëshmorëve?

2. Pyetje e dytë për DSHP-në, është cilët operatorë ekonomik e kanë fituar tenderin për pastrimin e rrugëve nga bora.

3. Pyetje për DZHE-në sektori i Bujqësisë, Bujqit e komunës së Shtimes e kanë ngritur shqetësimin që ata i kanë quajtur subvencione ndërsa ne i kemi marrë si grante qeveritare, në kuadër të ndihmave për dëmet që i kanë pasë nga të reshurat e shkaktuara në bujqësi, a ka diçka se kur mund ti marrin këto?

z.Perparim Ramusa; Përshëndetje për të gjithë, unë nuk kam pyetje, por vetëm po kërkoj falje që u inkuadrova pak me vonesë.

Pika 3

Shqyrtimi i Raportit Financiar, Janar-Shtator 2020

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Lexoi rekomandimin e KPF-së, dhe në vazhdim fjalën ja dha Kimete Ukaj.

znj.Kimete Ukaj, Zyrtare Kryesore Financiare; Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, prezantoi Raportin Financiar, Janar-Shtator 2020. Bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-40, Neni 58 si dhe Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048, Neni 45.4 prezantojmë raportin mbi ecuritë financiare të organizatës sonë buxhetore (617) për periudhën Janar - Shtator 2020 duke përfshirë: Të hyrat Buxhetore të realizuara si dhe Shpenzimet buxhetore për të gjitha programet dhe kategoritë ekonomike. Gjatë kësaj periudhe organizata buxhetore shpenzoi gjithsej: 4,578,658.68 € ose 47.24% nga vlera totale e buxhetit të miratuar për vitin 2020, ndërsa

shpenzoj 69% në raport me Alokimet e pranuar për këtë periudhë përfshirë të gjitha burimet e financimit.

Realizimi i Buxhetit në raport me Buxhetin e miratuar për 2020 – siç shihet edhe në tabelën Nr.4 për periudhën Janar-Shtator 2020 është në shumën 4,578,658.68€ shprehur në raport me Buxhetin e miratuar me shkallën 47.24%, në total për periudhën në fjalë. Ne kemi prezentuar realizimin e Buxhetit sipas burimeve të financimit dhe pesë kategorive ekonomike, e që ecuria e realizimit të buxhetit vërehet në tabelë ku shihet se nga burimi i financimit 10-GQ janë realizuar shpenzimet në masën prej 56.08%, ndërsa nga burimi i financimit 21-THV është realizuar 16.15%, ndërsa 22-THV 30.82% shkalla e ulët e realizimit është për shkak të proceseve administrative të fillim vitit, si dhe për shkak të gjendjes së krijuar me virusin COVID-19 .

Realizimi i Buxhetit në raport me alokimet e pranuar për periudhën Janar-Shtator TM3, 2020, shihet në kolonën “F” të tabelave. Raporti në mes alokimit e shpenzimit për periudhën Janar-Shtator 2020 janë pranuar-alokuar mjete në shumën 6,635,683.15€ dhe janë shpenzuar 4,578,658.68 € apo shprehur në përqindje: 69% është realizuar shpenzimi në këtë periudhë.

Sa i përket raportit si dokument e keni marrë me kohë në formë të shkruar, prandaj unë ju ftoj që ta aprovoni, dhe nëse ka ndonjë pyetje jam këtu për tu përgjigjur, (shih dokumentin).

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Naim Zejna; Faleminderit për fjalën, unë edhe në KPF, thash se ky vit ka qenë i rëndë, kështu që me 47.24 % në raport me Buxhetin e miratuar, si dhe 69 % në raport me Alokimet e pranuar për këtë periudhë unë mendoj se është vlerë e vogël e shpenzimeve. Shqetësimi jonë është se çka u bë me pjesën tjetër të alokimeve, si dhe ku po mbetet projekti kapital i huamarrjes për trajtimin e ujërave të zeza. Subvencione dhe Transfere me 14.82% është ende më keq, edhe pse po e kuptoj që është gjendje e vështirë. Alokimet janë bërë në muajin Korrik, por nga atëherë i kemi katër muaj që kanë qewënë në dispozicion për tu shpenzuar mjetet financiare, unë po kërkoj që mos të ndodhë që të nguteni dhe mjetet financiare ti shpenzoni në dy muajt e fundit të vitit.

z.Ruzhdi Jashari: Ashtu sikurse në KPF-ë vërejtjet tona janë të shpenzimet kapitale, e që ka të bëjë pikërisht me projektin më të madh për ndërtimin e Kolektorit për përpunimin e ujërave të zeza, e që është me huamarrje. Punë në teren nuk po shihen që po bëhen. Gypat në ara po shtrembërohen nga ndikimet klimatike. Kontrollim nuk ka, raport për këtë projekt nuk ka, kështu që ka përgjegjësi dhe duhet të jep llogari Kryetari sepse është nënshkruar i Kontratës. Raporti ka paraqitë ecurinë e lëvizjes së parasë publike, burimi i financimit nga të hyrat vetanake që është realizuar me 16.15%, është i vogël, mirëpo për shkak të gjendjes së krijuar me virusin COVID-19. Po ashtu është tepër e vogël shuma e shpenzimeve të përgjithshme me 47.24% në raport me Buxhetin e miratuar, kjo len shumë për të dëshiruar.

znj.Arbresha Syla; Kemi diskutuar edhe në KPF-ë, kështu që në raport janë prezentuar ecuritë financiare për këtë periudhë, por edhe të metat e mangësitë për të cilat një pjesë të madhe e merr aspekti i pandemisë KOVID19. Zyrtarja Kimete Ukaj ka dhënë sqarime në KPF-ë dhe ka thënë se alokimet janë bërë shumë vonë tek në muajin Korrik për me mujt me i futë në procedurë projektet kapitale. Ne qëndrojmë më mirë në raport me Komunitat tjera, është raport mbi gjendjen reale dhe unë mendoj se si i tillë duhet të aprovohet.

z.Muhamet Ademaj; E falënderoj zyrtaren për raportin. Sa i përket të hyrave ato kanë shënuar regres, por unë po shpresoj se do të përfundohen të gjitha projektet e planifikuara.

znj.Kimete Ukaj, Zyrtare Kryesore Financiare; Nga raporti shihet se alokimet, i ka bërë Ministria e Financave në muajin Korrik. Te projekti i Kolektorit, është prezentuar në raport se çka është shpenzuar e çka jo. Në fund të vitit do të prezantohen të gjitha të dhënat. Parashihet që për shkak të pandemisë sigurisht që shpenzimet do të jenë më të vogla.

Kryetari, z.Naim Ismajli; Përshëndetje, për anëtarët e Kuvendit. I kuptoj shqetësimet e juaja për të hyrat dhe shpenzimet. Po i referohem raportit nëse i analizojmë statistikën, dhe nëse i marrim shifrat fillestare, e shohim se ka pas ndryshime. Pastaj nese e shihni se alokimet janë bërë tek në muajin Korrik-Gusht, ka qenë shumë vonë për të procesuar me projektet. Me 70% të shpenzimeve në muajin e nëntë është shumë solid, dhe kur i shtohet kësaj që dinamika e pagesave shtohet në dy muajt e fundit, medoj se në fund do të dalim me realizimin e shpenzimeve normale. Sa i përket investimeve me Kredi ato i nënshkruan Ministria, si dhe monitorimin e punimeve po ashtu e bënë Ministria. Është e vërtetë se dinamika e realizimit të këtij projekti ka ra por siç e dini kjo ka rënë për shkak të pandemisë. Investitori është ai që e përcakton inensitetin e punimeve. Ky është një nga projektet kapitale më të mëdha të komunës së Shtimes, ku qytetarët nuk paguajnë asnjë cent. Kështu pra niveli prej 70% të shpenzimeve të realizuara është brenda konturave, edhe sikur mos të kishte pandemi, sepse zakonisht realizimi i buxhetit në këtë periudhë sillet rreth 70-75%.

z.Ruzhdi Jashari; Për dy çështje që i tha Kryetari kemi mospajtim, e para nuk qëndron fakti se për projektin e Kolektorit për përpunimin e ujërave të zeza që është me huamarrje nuk paguajnë asnjë cent qytetarët, sepse tatimet dhe taksat shkojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës. Dhe e dyta nuk ka qenë KOVID19 pengesa për sa i përket realizimit të projekteve ndërtimore. Ka këtu krejt diçka tjetër.

Kryetari, z.Naim Ismajli; Po jap arsytim për qytetarët e jo për ata që nuk duan ta kuptojnë. Buxheti i Kosovës i ka kufijtë e tijë buxhetor, dhe banorët nuk kanë me paguar asnjë cent për këtë projekt. Ndërkaq për projektet kapitale unë thash për ata që kanë sy e vesh se alokimet kanë ndodhur në muajin Korrik-Gusht. Kështu që projektet kanë ndodhur në vazhdim në muajt Gusht-Shtator. Dmth. Sot ne po flasim për një sukses edhe për faktin sepse alokimet i kemi të gjitha.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 17 anëtarëve prezent On-line.

*** Kuvendi i Komunës, me 12 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 5 vota “Abstenim” aprovoi, Raportin nëntëmuor financiar të Komunës së Shtimes për Janar – Shtator 2020.**

Pika 4

Draft-Rregullore Komunale për Tatimin në Pronë për vitin 2021, pas diskutimit publik

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Kimete Ukaj.

znj.Kimete Ukaj, Zyrtare Kryesore Financiare; Kuvendi ka marrë vendim që këtë rregullore ta qojë në diskutim publik, kështu pra kjo rregullore ka kaluar procesin e diskutimit publik, dhe përveq që Fehmi Hysenaj ka pas disa propozime, të tjera nuk ka pasë. Materialin për këtë rregullore e keni pas, unë nuk kam më tepër të shtoj por nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem. Ju ftoj që këtë rregullore ta aprovoni.

z.Naim Zejna; U tha nga zyrtarja e financave se ka pas diskutim, mirëpo ne kemi kërkuar që të njoftohemi, kështu që unë nuk e kam ditë. Unë edhe në mbledhjen e KPF-së kam bërë pyetje se a jemi mirë me ndarjen e zonave, dhe kam propozuar që ndarjha e zonave të bëhet më e butë ashtu që të bëhet ndarja edhe me nën-ndarje psh. me ABC etj. që mendoj se do të kishim një ndarje më precize dhe më adekuate.

znj.Kimete Ukaj, Zyrtare Kryesore Financiare; Ne këtu në Kuvend mund të vendosim vetëm sa i përket normave tatimore, e jo edhe të ndarjes së zonave, sepse tani ajo është kompetencë e Ministrisë. Sa u përket normave tatimore, ato ne i kemi normat më të ulëta, kështu që nuk kemi ku shkojmë më poshtë përveq nëse dëshironi që ti ngritni ato.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 18 anëtarëve prezent On-line.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht aprovoi Rregulloren Komunale për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2021.**

Rishqyrtimi i katër Vendimeve të Kuvendit Npi-01/209; Npi-01/210; Npi-01/211; Npi-01/217, sipas kërkesës së MAPL-së

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Kryetarit.

Kryetari, z.Naim Ismajli; Fillimisht po u sqaroi se të katër rastet i kemi sqaruar me MAPL-në dhe ata na kanë thënë se ishte formati i shkrimit arsyeja pse janë kthyer këto katër vendime në rishqyrtim. Po ashtu e kemi sqaruar edhe çështjen e Inventarizimit për sa i përket Listës së pronave komunale për dhënien në shfrytëzim për vitin 2020, ata na kanë thënë se këtë kriter nuk do ta marrin parasysh me arsyetimin se është futur me vonesë dhe me qëllim që mos të pengohet zhvillimi ekonomik. Kështu pra ne do ta përpilojmë listën e pronave për vitin 2021, ndërsa këto katër vendime të propozuara me pikat 6, 7, 8 dhe 9 janë në përputhje me ligjin.

z.Ruzhdi Jashari; E dimë dinamikën e shpenzimeve të buxhetit, e dimë edhe spjegimin e Kryetarit që e ka dhënë në Komitetin për Politikë dhe Financa, mirëpo nuk e di pse kjo nguti kaq e madhe nga ana juaj për këto vendime. Komunitet tjerë kanë rregullore të posaqme për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, e ne si Komunitet nuk e kemi, një rregullore të tillë. Nuk ka miratim nga Ministria, për sa i përket Listës së pronave për dhënien në shfrytëzim, kjo është vetëm një bllof i Kryetarit. Ne qysh në Shtator kemi thënë se nuk bënë të merren vendime të tilla me emra të atyre që kanë bërë kërkesa, ja ku janë vendimet që janë marrë me emra e mbiemra.

z.Naim Zejna; Ne si grup parlamentar i subjektit politik të LDK-së e mbështesim anulimin e këtyre katër vendimeve, sipas rekomandimit që e ka dhënë Ministria.

znj.Arbresha Syla; Kjo është çështje procedurale, nuk bënë me i dhënë kahje tjetër. Ashtu si ka propozuar Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal, ne do ti votojmë.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 18 anëtarëve prezent On-line.

1. Kuvendi i Komunës, me 17 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” vendosi të ANULOJË Vendimin e Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi-01/209, të datës 29.09.2020, për shpallje me interes të përgjithshëm të pronave të paluajtshme të Komunës së Shtimes, N.K : Nr.230-0; Me sipërfaqe 35231m²; Si dhe N.K : Nr.251-0; Me sipërfaqe 3859m²; Z. K. – Dugë; Evidentuar, Pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime. Periudha kohore e dhënies në shfrytëzim 30 vite.

2. Kuvendi i Komunës, me 17 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” vendosi të ANULOJË Vendimin e Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi-01/210, të datës 29.09.2020, për shpallje me interes të përgjithshëm, Ngastrën Kadastrale: Nr. 2270-4; Me sipërfaqe 33220m²; Zona Kadastrale – Shtime; Pasuri Shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime. Periudha kohore e dhënies në shfrytëzim 15 vite.

3. Kuvendi i Komunës, me 17 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” vendosi të ANULOJË Vendimin e Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi-01/211, të datës: 29.09.2020, me të cilin aprovohet kërkesa Nr.01-070/05-6235/20 e datës: 09.03.2020, të z.Sali Beqaj nga fshati Petrovë, për Zhvendosjen e N. K. Nr.313/3, 313/4, 313/5 dhe 313/6, Z. K. – Davidovc, Evidentuar pronë e Sali Beqaj – Petrovë, me gjithsej sipërfaqe prej 1 hektar e 2 ari, (10.248m²), duke zhvendosur me pronën e paluajtshme të Komunës së Shtimes, me sipërfaqen e barabartë në pjesën e N. K. Nr.333/4, Z. K. – Davidovc, Evidentuar Pasuri Shoqërore e Kuvendit Komunal – Shtime.

4. Kuvendi i Komunës, me 17 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” vendosi të ANULOJË Vendimin e Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi-01/217, të datës 29.09.2020, për shpallje me interes të përgjithshëm, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, pronën e

paluajtshme Komunale, N. K. Nr.333/3, me sipërfaqe:8000m², si dhe N.K. Nr.333/4, me sipërfaqe:21986m², Z.K-Davidovc. Evidentuar Pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal – Shtime.

Pika 6

Propozim-Vendim për shpalljen me Interes Publik të Ngastrave Kadastrale, Nr.313/3, 313/4, 313/5 dhe 313/6, Z.K – Davidovc. evidentuar pronë e Sali Beqaj – Petrovë

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Naim Zejna; Ne si grup parlamentar i subjektit politik të LDK-së, kemi thënë që të kthehet krejt në pikën zero, me arsyetimin që ta kemi një akordim të palës me administratën Komunale. Ne po kërkojmë që të precizohet mirë parcela sepse orto-fotot që na janë ofruar sigurisht janë të vjetra ndërsa ne i kemi shumë më të qarta, prandaj po kërkojmë nga drejtoria që të na ofrojnë orto-foto dhe skica më të detajuara.

z.Muhamet Ademaj; Unë e mbështes rekomandimin e KPF-së dhe do ta votoj ashtu.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 19 anëtarëve prezent On-line.

*** Kuvendi i Komunës, me 16 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 3 vota “Abstenim”**
APROVOI Vendimin për shpalljen me Interes Publik të Ngastrave Kadastrale me numër Nr.313/3, 313/4, 313/5 dhe 313/6, Zona Kadastrale – Davidovc, Kultura: Kullosë e klasës së -I- . Evidentuar pronë e Sali Beqaj – Petrovë, me gjithsej sipërfaqe: 10.248m², (Dhjetë mijë e dyqind e katërdhjet e tetë).

Pika 7

Propozim-Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën Komunale, Nr.230/0 dhe Nr.251/0, Z.K-Dugë

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Naim Zejna; Sa i përket kësaj pike ne jemi “Për” por vetëm më shqetëson fakti se sipërfaqja është pak e madhe.

z.Ruzhdi Jashari; Ne si Vetvendosje e kemi nda mendimin tonë për “Jo” sepse nuk ka një specifikim të pronave ose një Listë të pronave që do të ipeshin në shfrytëzim gjatë këtijë viti. Kjo listë duhej të miratohej në Kuvend dhe të bëhej publike, me qëllim që të jetë i njoftuar edhe qytetari por edhe bizneset e interesuara. Ndërsa ato që po i thot Kryetari janë qështje manipulative. Kjo formë e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim nuk po krijon qasje të barabart për qytetarët në konkurrencë. Kemi propozime të vendimeve të Kryetarit që janë bërë me emra e mbiemra gjë që është kundërligjore. Kështu po bëhet një proces Ad-hoc i dhënies së pronës komunale në shfrytëzim. E dimë që kemi dhënie të pronave njerëzve të caktuar me interesa të caktuara, kemi Shashivari këtu Shashivari atje. Nuk jemi kundër zhvillimit ekonomik e dhënis së pronës komunale në shfrytëzim por vetem duke respektuar procedurat ligjore dhe konkurrencën e lirë. Sa i përket bizneseve ne e kemi aprovuar në Kuvend, Zonën Ekonomike në afërsi të fshatit Gllavicë, atje duhet të orientohen bizneset.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 18 anëtarëve prezent On-line.

*** Kuvendi i Komunës, me 16 vota “Për” me 1 votë “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim”**
APROVOI Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën Komunale, si vijon:

- 1. Pjesë nga Prona e pa lujtshme e Komunës te Vendi i quajtur “Kodra e Mustabashit”, Ngastra Kadastrale: Nr. P-72809029-00230-0; Me sipërfaqe 35231m²; Zona Kadastrale – Dugë; Kultura – Kullosë e klasit të 5; Evidentuar, Pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime. Periudha kohore e dhënies në shfrytëzim 99 vite.**
- 2. Prona e palujtshme e Komunës te Vendi i quajtur “Ahishta për mbi shpi”, Ngastra Kadastrale: Nr. P-72809029-00251-0; Me sipërfaqe 3859m²; Zona Kadastrale – Dugë; Kultura – Kullosë e klasit të 5; Evidentuar, Pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime. Periudha kohore e dhënies në shfrytëzim është 99 vite.**

Pika 8

Propozim-Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtë pronën Komunale, Nr.2270/4, Z.K-Shtime

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Naim Zejna; Edhe në KPF-ë kemi votuar “Për” vërejtje kemi dhënë për drejtorinë për Orto-fotot e vjetra. Ajo zonë ku është kërkuar prona komunale që ti epet në shfrytëzim edhe ashtu është zonë për biznese, por ne po kërkojmë që të precizohet parcela që do të epet në shfrytëzim.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 19 anëtarëve prezent On-line.

* **Kuvendi i Komunës, me 16 vota “Për” me 2 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim”**
APROVOI Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtë pronën Komunale, si vijon:

1. **Prona e pa lujtshme e Komunës te Vendi i quajtur “Gështenja”, Ngastra Kadastrale: Nr. P-72809093-02270-4; Me sipërfaqe 33220m²; Zona Kadastrale – Shtime; Kultura – Kullosë e klasit të tretë; Evidentuar, “Pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime”. Periudha kohore e dhënies në shfrytëzim është 15 vite.**

Pika 9

Propozim-Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën Komunale, Nr.333/3 dhe 333/4, Z.K-Davidovc

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Naim Zejna; Këtu ne e ndajmë mendimin dhe jemi “Kundër” sepse është zonë e uzurpuar. Ne propozojmë që bizneset le të bëjnë kërkesa dhe le të shkojnë në Zonën Ekonomike në Gllavicë.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 20 anëtarëve prezent On-line.

* **Kuvendi i Komunës, me 15 vota “Për” me 3 vota “Kundër” dhe me 2 votë “Abstenim”**
APROVOI Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën Komunale, si vijon:

1. **Ngastra Kadastrale me numër: P-72809023-00333-3, me sipërfaqe prej: 8000m², Kultura - Kullosë e klasit të -I- (parë). Z.K-Davidovc. Evidentuar “Pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal” – Shtime. Periudha kohore e dhënies në shfrytëzim është 99 vite.**
2. **Ngastra Kadastrale me numër: P-72809023-00333-4, me sipërfaqe prej: 21986m², Kultura - Kullosë e klasit të -I- (parë). Z.K-Davidovc. Evidentuar “Pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal” – Shtime. Periudha kohore e dhënies në shfrytëzim është 99 vite.**

Pika 10

Formimi i Komisionit për ndryshimin e Rregullores të Punës së Kuvendit dhe hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitn 2021

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Prezantoi këtë Propozim-Vendim në pika të shkurta për nevojën e formimit të këtyre Komisioneve, dhe në vazhdim hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Naim Zejna; Paraprakisht është mirë që të merremi vesh për formatin e këtyre Komisioneve. Kështu që ne propozojmë Valentina Halili-Ferati.

znj.Arbresha Sylja; Unë propozoj që nga grupi parlamentar i PDK-së të jetë Shefki Dauti dhe Adelina Beqaj.

z.Ruzhdi Jashari; Nga Vetvendosja propozoj Besnik Seferin. Komisioni duhet të punojë që me i eliminuar pengesat te rregullorja e punës që kanë të bëjnë me miratimin e rendit të ditës.

z.Naim Zejna; Replikë me Ruzhdi Jasharin, unë po i shoh vendimet në telefon.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 19 anëtarëve prezent On-line.


* Kuvendi i Komunës, me 15 vota “Për” me 3 vota “Kundër” dhe me 2 votë “Abstenim” APROVOI Vendimin për formimin e Komisionit për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2021, si dhe për ndryshimin e Rregullores të punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.4.2019, në këtë përbërje:

1. Medina Brahaj - kryesuese e Kuvendit
2. Valentina Halili - përfaqësues nga opozita
3. Besnik Seferi - përfaqësues nga opozita
4. Shefki Dauti - përfaqësues nga pozita
5. Adelina Beqa - përfaqësues nga pozita

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Ju falënderoj për pjesëmarrjen e juaj në mbledhjen On-Line, dhe meqenëse diskutime tjera nuk ka mbledhjen e përfundoi në ora 11.⁴⁴h.

Procesmbajtësi:

Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Kuvendit

Medina Brahaj

